**SHITBLERJET**(*SALES AND BUYES*):

**ADRESA E PRONARIT DHE FIRMA**
(*ADDRESS OF OWENER AND SIGNATURE*):

**ADRESA E POSEDUESIT DHE FIRMA**
(*ADDRESS OF POSSESSOR AND SIGNATURE*):

**PRONARI I RI** (*NEW OWNER*):

**SKEDUESI** (*COMPILER*): AIDA BOJDANI

**DATA** (*DATE*): 03/12/2003

**KOMISIONI I VLERËSIMIT** (*COMMISSION OF ASSESSMENT*):

1.
2.
3.

**DREJTOR**
**(DIRECTOR)**

**Në bazë të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", objekti klasifikohet pasuri kulturore..**
***(According to Law 27/2018 "On Cultural Heritage and Museums", the object is cultural property.)***

**Lëvizja e objektit shoqërohet vetëm me lejen e Ministrisë së Kulturës. *(The movement of the object should be executed only upon the permission of the Ministry of Culture)***

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
***REPUBLIC OF ALBANIA***
**MINISTRIA E KULTURËS**
***MINISTRY OF CULTURE***
**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**
***NATIONAL INSTITUTE OF CULTURAL HERITAGE REGISTRATION***

**Pronari** (*Owner*) SHTETI — *ID:* 0001
**Poseduesi**(*Possessor*) INSTITUTI I MONUMENTEVE KULTURORE — *ID:*

**Drejtori i IKRTK**(*Director of NICHR*)
**Tel: +355(4) 22 269 03**
***Web: www.ikrtk.gov.al***

**Vula** (Seal)

## CERTIFIKATË OBJEKTI

**NUMËR** (*NUMBER*): 31838

**VENDNDODHJA** (*LOCATION*):

**Shteti** (*State*): Shqipëri **Qarku** (*Region*): Qark **Rrethi** (*District*): Qytet

**Qytet/Fshat**(*City/Country*): Elbasan **Rruga** (*Street*): -

**FUSHA** (*DOMAIN*): ARKEOLOGJI

**KATEGORIA** (*CATEGORY*): GjurmëArkeologjike

**TIPI** (*TYPE*): Gjetje te ndryshme

**TITULLI** (*TITLE*): Termet dhe Nymfeu ( Ad-Quintum) Elbasan

**MATERIALI** (*MATERIAL*): Gur

**FOTOGRAFIA E OBJEKTIT 6 me 9 (cm)**
(*PHOTOGRAPHY OF OBJECT 6 by 9 cm*)



**Nr. i Regjistrit** ***(No. of Register)*:**
**Nr. i Inventarit** ***(No. of Inventory)*:** 315

**KATALOGU (CATALOGUE)**
""

**TË DHËNAT KRYESORE TË OBJEKTIT**
**MAJOR DATA OF THE OBJECT.**

**TEKNIKA** *(TECHNIQUE):* E perzier

**KULTURA** *(CULTURE):* Qytetare Ilire

**PERIUDHA** *(PERIOD):* Romake sh2pk-4pask (-)

**AUTORI** *(AUTHOR):* ANONIM ANONIM

**PËRMASAT** *(DIMENSIONS):*

**Gjatësia** *(Length)*: - **Gjërësia** *(Width)*: - **Lartësia** *(Height)*: -
**Njësia** *(Unit)*: SIPERFAQJA

**PESHA** *(WEIGHT):*

**VLERA** *(VALUE):* 0 Lek

**DORËZUESI** *(DELIVERER):*

**TË DHËNA TË TJERA** *(OTHER DATA):*

**PËRSHKRIMI** *(DESCRIPTION):*

Ne perendim te Elbasanit, ne kilometrin e shtate te rruges qe te çon nga ky qytet ne Peqin, ishin konstatuar mbeturinat e nje godine antike, te njohur nga vendasit me toponimin Kalaja e Bradasheshit. Vrojtimet e para treguan se nuk kishim te benim me nje ndertim mbrojtes, siç mund te pritej nga emri, por me nje nymfe antik te ndertuar ne funksion te rruges Egnatia, si pjese e stacionit Ad Quintum. Nimfeu perbehet nga mur teracimi, ne te cilin ndodhen dy depo uji dhe nga nje e trete qe eshte burim uji, te mbuluara me qemer. Para tij shtrihet nje platforme. Termet kane nje apodyterium, ne lindje frigidarium, ne perendim ka dy tepidarium, paralel me to ka dy dhoma te nxehta. Ndertimi i tyre i takon shek.III-IV e.s. Ne kerkim te vazhdimit te nymfeut drejt perendimit doli plotesisht ne drite nje godine termale, njeri prej ambjenteve te se ciles, frigidariumi, ruhej pothuajse i plote. Nymfeu dhe termet perbenin nje kompleks te vetem arkitektonik, qe duhej t'u sherbente udhetareve qe kalonin neper rrugen Egnatia. Te dy monumentet jane vendosur ne nje plan, mbi nje terace te krijuar midis dy muresh, pothuaj paralel midis tyre. Fasada e nymfeut krijohet nga pjesa lindore e murit te teracimit me gjatesi 26 m, qe ndahet nga kontraforte te vendosura çdo 2.5 m. Ne distanca te pabarabarta jane vendosur brenda tij tre hauze. Perpara fasades shtrihet nje shesh 11 m i gjere, i kufizuar nga muri i teracimit. Hauzet e ujit i kane hyrjet ne gjysmen lindore te sheshit me nje vendosje simetrike dhe hapesira te pabarabarta drite. Sheshi perpara murit mbajtes ishte sigurisht ne funksion te dy pjeseve te monumentit per qarkullimin e njerezve, qe mbushnin uje per nevojat e tyre ose te banjos. Hyrja per ne shesh behej ne kendin juglindor nepermjet nje shkalle 1.05 m te gjere. Ne perendim te nymfeut jane ndertuar termet, qe zene nje siperfaqe prej rreth 130 m2. Dallojme aty dhomen e zhveshjes (apodyterium), ne formen e nje salle te gjate, qe lidhej ne lindje me dhomen e fresket (frigidarium) dhe nepermjet dy dyersh me dy ndarjet e ngrohta (tepidarium) ne perendim. Ne nje vendosje paralele me keto te fundit vijne ambjentet e nxehta (sudatio dhe laconicum, ku ndodhet edhe vaska, e vendosur ne murin jugor te dhomes ne forme katerkendeshi). Si anekse te godines jane vendosur ambjentet per personelin, furren dhe nje ambjent ne forme korridori te ngushte. Ngritja e termeve dhe nymfeut ne afersi te rruges Egnatia nenkupton qenien e nje stacioni rrugor, pjese te te cilit do te ishin te dy monumenteve, por sidoqofte nuk mund te flitet per nje qender me shtrirje te madhe dhe me jete intensive. Stacioni i vogel i Bradasheshit u krijua ne kohen kur Skampini, qe nuk ishte me teper se 7 km larg, sapo zhvillohej si qytet.
Gjendja e monumentit nuk eshte shume e mire. Ka nevoj per konsolidime qemeresh dhe pastrim nga bimesia.

**RESTAURIMI:** Çdo lloj ndërhyrje; kush e ka bërë, si dhe rilevimi topologjik i objekteve të paluajtshme.

*(RESTORATION):* *Any kind of restoration work; the person(s) that have carried it out, as well as the topographic survey of immovable objects.*

Plotesime ne kartele:Silva Breshani
Dt:12.09.2008 (informacion,foto,dosja e monumenteve nga DRKK Tirane).
Plotesim ne kartele:F.Yzeiri
Dt.19.11.2014 kartel e drkk Durres
Plotesime në kartelë: Ferdinant Yzeiri
dt.05.06.2015
MINISTRIA E KULTURES
MINISTRI
URDHER
Nr.41 date,02.02.2015
SHPALLJE ZONE TE MBROJTUR
Ne vijim te shkreses nr. 20 prot, date 22.01.2015 te Keshillit Kombetar te Restaurimeve konstatova se ne mbledhjen e dates 10.03.2014 Keshilli Kombetar i Restaurimeve me Vendimin nr.07, date 10.03.2014, ka shqyrtuar dokumentacionin mbi propozimet e diskutuara ne Keshillin Shkencor per shpallje zone te mbrojtur.
Nisur sa me siper, ne mbeshtetje te nenit 102, paragrafi 4 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperisg, si dhe te nenit 32 te ligjit Nr. 9048, date 07.04.2003, "Per trashegimine kulturore" i ndryshuar.
URDHEROJ:
I. Shpalljen zone e mbrojtur per "Nymfeu dhe Termet e stacionit Ad Quintu".Bradashesh, Elbasan sipas hartes bashkelidhur.
2. Ngarkohet Qendra Kombetare e Inventarizimit te Pasurive Kulturore per regjistrimin e ketij urdhri.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike prane Institutit te Monumenteve te Kultures "Gani Strazimiri" per njoftimin e ketij urdhri.
Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.
MINISTRI
MIRELA KUMBARO FURXHI

**SHKALLA E DËMTIMIT** *(SCALE OF DAMAGE)*: 3

1. Shumë Mirë; ... 10. Shumë Keq *(1. Very Good; ... 10. Very Bad)*

**ORIGJINALE/KOPJE** *(ORIGINAL/COPY)*: Origjinal

**VEND ORIGJINA** *(ORIGIN PLACE)*:

**VENDI I RUAJTJES** *(STORAGE LOCATION)*:

**TRASHËGIMI** *(HERITAGE)*: **Po**

**HISTORIKU:** Ku dhe kur është zbuluar; kur ka marrë statusin e trashëgimisë kulturore.

(*HISTORIC INFORMATION*): *Place and date of discovery, date of gaining the status of cultural heritage.*

Eshte shpallur M.Kulture ne vitin 1963, me vendimin e Rektoratit te Universitetit Shteteror te Tiranes, nr.6, dt.15.01.1963 "Mbi shpalljen e monumenteve te kultures".

**LËVIZJET E OBJEKTIT** *(MOVEMENTS OF OBJECT)*:

**BIBLIOGRAFIA** *(BIBLIOGRAPHY)*:

N.Ceka, L.Papajani, Monumentet, 1972/4.Monumentet 1/1982, Kronika e punimeve restauruese per vitet 1980-1981, Termat e stacionit Ad Quintum (Bradashesh-Elbasan). L.Papajani, fq. 120.